

Fadil Curri, Shkup

POEZI SIPAS GJURMËS “LARG SYVE, LARG ZEMRËS”

Besim Xhelili: “Sy të pafajshëm...” (poezi), Prishtinë 2016

Poeti Besim Xhelili përgjatë përshkrimit krijon fabulë pamjesh e ndodhish, ndërlidhje botërash me jetë e pasjetë. Shpirtërorja me truporen gërshetohen ndërsjellë në saje të syve si urë ndërlidhëse, që netëve të ftohta ngrohin me ndezjen e tyre. Dashuria është e pranishme nga larg, edhe e pazë, por kurrë e pashpirt, kurrë e shuar, sepse është lulishte që, edhe kur nuk shikohet, përjetohet me syrin e nuhatjes, të shijimit e dëgjimit, bile është burg veçimi pa praninë e saj.

Sytë e dashurisë në poezinë e Xhelilit shohin keqardhje për mungesën, edhe në dëshpërim janë falës ndaj mungesës, janë urues. Përmes syve të mungesës sheh edhe shembjen e gjumit përgjatë ditëve, javëve e muajve, përditshmërisë, shndërrohet në kulturë frymëzimi për poetin, i cili shpesh konvertohet në protagonist erotik, i padorëzueshëm në ndjekjen për rikthim të saj.

Të gjitha mynxyrat janë peng i dashurisë, edhe vdekja. Shpëtimtare nga agonia është edhe një puthje e vockël. Syri është mjet shprese për kthim në jetë, qoftë si marrës nga syri i frymëzimit ose si dhënës i poetit. Duket se nga syri i vet jep shumë, gati të pamundshmen, por nga syri tjetër është i zhgënjyer, i dëshpëruar, sepse e shpreson të munguarën vetëm kur do të ngre dollinë e vdekjes dhe të shënojë çlirimin nga pengu i dashurisë. Sikur besëdhënia i ngjan dashurive të baladave popullore të pafata, qoftë e vetëm një rës palë, sa dështimi mbyllet me një kronikë morti të poetizuar. Elementin folklorik në poezinë e Besim Xhelilit e hasim edhe në tabllotë analoge me lulet mbi varr, vizitën te ai, amanetin e flijimit me vdekje.

Shtjellimi i syrit nuk shihet i veçuar, por i ambientuar rrotull tij, ku nga oqeani i qerpikëve rrjedhin lumë lotësh, ka edhe rreze ylberi, botë kujtimesh, i jep qytetit mrekullinë e paparë. Gjithçka që e plotëron fshehtësinë e magjikes së syrit, është rrotullama e syrit; bebet, qerpikët, shikimi, buzët, faqet dhe nuk shkon më larg se koka, pranësia e saj. Ndryshe nga disa entuziastë erotikë, që shpesh pandehin se pornografia poetike sjell art të shpirtit, te tufa poetike “Sy të pafajshëm” majën e dashurisë e madhështon shpirtërorja, mungesa dhe shpresa e rikthimit të dashurisë. As edhe një tablllo gjymtyrore, pos kokëqafës, nuk është kusht dashurie. Platonikja është kredo frymëzimitare në këtë poezi, ndonëse sipas ndonjë vargu ajo sikur është bërë e ndjerë. Fshehtësia e syve është më e madhe se bukuria e yjeve. Sytë shohin madhësinë vetëflijimtare të tërësisë së përbashkët. Autori i jep kuptim hyjnor syve të dashurisë, si e kuptojme te poezia “Kontratë”:

*O mike, me Zotin kam hyrë në një kontratë
Ditët e mia kanë kuptim ngase të dashuroj,
Prandaj të dua dhe të dëshiroj për çdo natë
Si mundem Atë ta tradhtoj e veten ta dënoj...?!*

Binomi shkak-pasojë pa nyjzimin e dashurisë nuk e ka ekzistencën fatlume, së paku pa praninë, sepse është provë e Zotit dhe sprovë bandili që pajtohet edhe me mbytje për lumturinë e dashuridhënies. Ngushëllim i pasjetës është vetëm loti mbi varr, pa të vështirë se edhe engjëjt do ta bartnin te vendi ku do të gëzoheshin insektet për kërmën, si e quan mohueshëm dështimin, cofëtinë. Bile kërkon që edhe vrasjen ta ketë si dështak, si i paaftë me dashuri inekzistente, vetëm ëndërralltare.

Arti i fotografisë nuk ia kalon magjisë së syve të saj, sepse është dashuri e besës, jo e hëpërhësë. Ja disa vargje të profilit të saj nga poezia “Besa”:

*Nëse do të më vizitosh aty ku vuajnë të dashuruarit
Pranë kur të vish me një lule në dorë e një lot në sy,
Merr forcë dhe e buzëqeshur një lutje thuaje
Ngadalë unë në varr do të qaj plot mall i gëzuar,
Mandej një lot imi do të bashkohet me tëndin –
Sidoqoftë jeta ime e amshimit ty do të të dua
Prapa nuk kthehet besa e dhënë një mikeje.*

Në këto shprehje dashuria merr trajtën baladeske, i ngjan poezia zhanrit të krijimeve popullore të dashurisë së pafat, por e përjetësuar në shenjtërinë e trikohësisë edhe në modernitetin e përdhosur me gjoja dashuri, por të deformuar. Folklorikja ka nëntekst të dendur në poezinë e këtij libri, qoftë edhe nga semantika e numrit. Besëdhënia e të dyve për shkrirje në një dashuri është te Kanga e Ashik Imerit me Mejreme Devojkën, Begzades, Hasan Aga e Çika Potureshë e disa balada të tjera. Pengesa e mungesa e dashurisë është te ato, është edhe në këtë poezi. Numrat dy në një simbolikisht i gjejmë si te popullorja, ashtu edhe te poezia e shkruar; dy dashnorë janë për bashkim, një është për ndarje, edhe në këto poezi, fati i hidhët. Këtu kemi edhe dy kaptinat e librit (“Sy të pafajshëm” e “Dallgë mendimesh”) duan të shkrihen në një porosi të dy palë syve të ndarë që mëtojnë shkrirjen në një. Numri ka edhe kuptimin metrik në libër. Ndërsa kaptina e parë shquhet kryesisht me katërvargëshin e shtatëvargëshin e shkrirë në një strofë-poezi, kaptina e dytë sikur është me e çliruar nga metrika dhe ritmi i fjaslës. Po ashtu me veçim numëror, e që i afrohet edhe stilit të autorit, është fundi tripikëshsh i poezisë.

Sytë, pos që janë përvëlím, vuajtje, mallkim, jo rrallë janë edhe ngushëllim, puhi që preh shpirtin e jep shpresë, janë mjete ndërkuptimi në dashuri, janë dorëzan i dashurisë së zembrës së ikur e që duhet kthyer. Sytë janë kumt i reales, çiltërisë së triumfit ose dështimit, por kurrë i zbrapsjes, janë busull e kalërimit shpirtëror, e frymëmarrjes dhe e frymëdhënies së njëri-tjetrës. Sytë nuk shohin vetëm dashnorin, por shohin e duan të afrojnë dashurinë, të jetë pjesë e vetes së saj, ata janë të pafajshëm dhe çiltërakë.

Pafajësinë e syve të tu më lejo ta ndjej
Në përçafim kur t'futem n'thellësinë e tyre
E boja e rubintë e tyre le t'ma shemb shpirtin
Kështu ato do t'më çlirojnë nga mëkati që të dua.
(Poezia "Pafajësi", faqe 72)

Prandaj kur e lexon poezinë e këtushme, të imponohet bindja se sytë janë laborator që stërhollon frymëzimin poetor kah njohja e misterit që krijon mrekulli me elemente hyjnore. Këtë fshehtësi duan edhe ta njohin sytë. Ose, te poezia titullore "Sy të pafajshëm", në të cilën sikur shfrytëzon proverbiale "Larg syve, larg zemrës" dhe që afërsinë e materializon si kusht të vërtetësisë, besueshmërisë dhe qëllimit.

*Të pafajshëm më thua se i ke sytë
Por, nga larg vështirë e kam të të besoj
Fshehtë radhiten vuajtjet mbi qafën time
Një fije ankthi më kaplon sa i kujtoj ato...
E di, kam ndjenja për ty që s'i shuan as lumi
Zemrën i dhurova tëndes, e ndjen se i ke dy
Merrma tash dhe frymën e qetëso tënden...*

Elementi i syve është në veten e parë të njëjësit, por është rrezatim i të gjitha vetave të njëjësit e të shumësit, përvojësim e ndërgegjësim lexuesor se sytë janë çelës i gjetjes së të humburës, i rinjësimit të copave, i behjes së mungesës, i nxënies së të panjohurës për edhe për të tjerët, e depersonazhëzon me përbotësim rolin e rëndësinë e syve, sepse, sikundër besohet nga njohësit e karakterologjisë, te ta është mrekullia e shprehjes "larg syve, larg zemrës". Sytë në poezinë e Besim Xhelilit janë fushë shtjellimi për ngacmim, trazim të paprekurës, të motivimit të shpirtërores me lëndoren brenda njeriut, perceptimit dhe shpërndarjes brenda racës së tij e më gjerë. Sytë janë vetja dhe jovetja e poetizuar që mëtojnë njësim harmonik, dashuror, në këtë rast edhe poetik si libër me porosi e shëndet goxha letrar.

Shkup, 29 korrik 2016
Fadil Curri